



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit



Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në dymbëdhjetë muajt e fundit ka ndërmarrë disa reforma të cilat kanë si synim të kthejnë besimin e publikut te sistemi arsimor dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit arsimor. Këto reforma kanë pasur mbështetjen e publikut si dhe vlerësimin e qarqeve profesionale.

Projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, i mbështetur nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë, përbën prioritetin strategjik të MASH-it gjatë viteve 2007-2010, pasi harmonizon objektivat e Qeverisë për një arsim cilësor e për të gjithë, me objektivat e strategjisë kombëtare të arsimit. Në hartimin e këtij projekti janë përfshirë institucionet qendrore dhe lokale, si dhe specialistë, nxënës, mësues, prindër, përfaqësues të shoqërisë civile.

Prioritetet dhe objektivat sektoriale, që paraqiten në planin e integruar të MASH për vitin 2008 e në vijim, marrin parasysh ndërthurjet me strategjitë e sektorëve të tjerë dhe ato ndërsektoriale, veçanërisht ato që lidhen me decentralizimin e shërbimeve, zhvillimin e pritshëm ekonomik, uljen e varfërisë, zhvillimet demografike dhe eliminimin gradual të shpërpjesëtimeve rajonale, sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë fëmijët dhe mbështetjen e shtresave në nevojë.

Korniza Kombëtare Shqiptare e Kualifikimeve është një zhvillim i rëndësishëm që paraqet prioritetet për realizimin e objektivave zhvillimore strategjike dhe qeveritare në përgatitjen e qytetarit shqiptar evropian me kulturë demokratike dhe i aftë për t’u përballur me sfidat e ekonomisë së tregut, konkurrues në nivel kombëtar dhe evropian.

Kjo kornizë shpreh në mënyrë sintetike të gjithë nivelet arsimore, zhvillimet strategjike të shërbimit arsimor të sotme e të perspektives në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Genc Pollo
Ministër i Arsimit dhe Shkencës

A handwritten signature in blue ink that reads "Genc Pollo".

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	8
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008	10
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë.....	16
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	17
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	19
Aneks 3	Investimet publike	20
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	22
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	23

1 Misioni i Ministrisë

Sistemi arsimor synon formimin e aftësive individuale për të përfituar dije e për t'i përdorur ato në interes të individit e të shoqërisë. Sfidat aktuale të sistemit arsimor në Shqipëri janë:

- edukimi i shoqërisë me vlerat demokratike dhe qytetare,
- edukimi i shprehive të suksesit në ekonominë e tregut,
- sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë, të bazuar në krijimin e mundësive dhe shanseve të barabarta për të gjithë shtetasit shqiptar.

Misioni i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës është të sigurojë:

- Edukimin e vlerave demokratike e kombëtare dhe zotërimin e njohurive dhe shprehive për ekonominë moderne të tregut;
- Edukim të mbështetur në të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti;
- Edukim cilësor sipas nevojave dhe interesave të individit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi e sipas standardeve evropiane;
- Barazi të shanseve për arsimim për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë;
- Arsimim bazë për të gjithë;
- Përshtatshmërinë e sistemit arsimor ndaj ndryshimeve;
- Mekanizmat e përgjegjshmërisë së shërbimit arsimor ndaj klientëve të drejtpërdrejtë dhe shoqërisë civile në tërësi;
- Efektivitetin e administratës arsimore qendrore dhe të njësive të saj vartëse;
- Efektivitetin dhe efikasitetin e burimeve njerëzore në arsim;
- Maksimizimin, efektivitetin dhe efikasitetin e burimeve financiare dhe materiale në arsim.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e arsimit bazë

Kjo Strategji, është në fazën e reflektimit të vërejtjeve të Komitetit të Planifikimit Strategjik, dhe ka vlerën e një platforme kombëtare.

Strategjia synon të garantojë një sistem arsimor kombëtar e modern, i cili nxit rritjen e qëndrueshme ekonomike, konsolidimin e demokracisë, dhe suksesin në dialogun dhe konkurrencën me vendet e rajonit e më gjerë.

Dokumenti identifikon disa prej zhvillimeve të rëndësishme gjatë periudhës 2007-2013, të udhëhequra nga zbatimi i ideve të kësaj strategjie si: qeverisja dhe menaxhimi i arsimit, përmirësimi i cilësisë së mësimnxënies, financimi i arsimit dhe zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e saj.

Në zbatim të ideve të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2007 - 2013 (SKAP), me mbështetjen financiare dhe ekspertizën teknike të Bankës Botërore, janë hartuar këto projekte komplemente të SKAP-it:

1. Projekti i arsimit për të gjithë "EFA/FTI" - i miratuar në nivel ndërkombëtar;
2. Decentralizimi i sistemit të arsimit,
3. Strategjia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional;
4. Strategjia Kombëtare e Arsimit parashkollor.
5. Projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim" (CBA)

Objektivi i projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim" është përmirësimi i cilësisë së kushteve të të nxënësve për të gjithë nxënësit dhe studentët, dhe rritja e frekuentimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm, në veçanti për shtresat në nevojë.

Strategjia sektoriale e arsimit të lartë

Në kuadër të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", me konsulencë të huaj është hartuar Strategjia e kombëtare e Arsimit të Lartë (SKAL) si pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. SKAL u është dërguar për mendim grupit parlamentar të arsimit dhe medias si edhe ministrive të linjës për t'u dërguar pastaj për miratim në Këshillin e Ministrave.

Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013 (SKAL), parashikon të ktheje IAL në institucione me autonomi të plotë në të gjithë veprimtarinë e tyre, dhe kërkon që këto institucione të jenë shumë të përgjegjshme për misionin që duhet të realizojnë për t'i shërbyer sa më mirë tregut të punës.

Qëllimi i kësaj strategjie është reformimi i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor me qëllim që Shqipëria të zërë vend të rëndësishëm në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Strategjia parashikon realizimin e një reforme institucionale për ndërtimin e një sistemi bashkëkohor të shkencës, e cila synon integrimin në universitete të të gjitha instituteve kërkimore jashtë universiteteve; integrimin organik, në të gjitha planet, të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, për të krijuar sistemin e shkencës, në qendër të të cilit do të jenë universitetet. Në këtë kuadër është në proces hartimi i Dokumenti i Orientimit të Kërkimit Shkencor në Shqipëri, në themel të së cilës qëndron integrimi i kërkimit me mësimin në arsimin e lartë.

Aktualisht po punohet për hartimin e planit të veprimit të Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë, 2007-2013, i cili mbështetet në përcaktimin e politikave të zhvillimit dhe kryerjen e studimeve të fokusuara në çështje të veçanta të strategjisë.

Qëllimet

Politikat arsimore janë hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASH), rajonal (DAR dhe ZA), lokal (shkollat) si dhe i institucioneve që varen nga MASH.
- Decentralizimi i shërbimit arsimor.
- Rritja e autonomisë së shkollave.
- Instalimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor (EMIS).
- Reformimi i sistemit të financimit dhe rritja e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.
- Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së shërbimit arsimor.
- Rritja e viteve të shkollimit, duke zgjatur periudhën e arsimit bazë nga 8 në 9 vjet, për të rritur mesataren e viteve të shkollimit të popullsisë nga 9.6 në 11.2 deri në 2015.
- Rritja e raportit të regjistrimit neto (NER) nga 94% në 95% të nxënësve që frekuentojnë arsimin bazë deri në 2015.
- Rritja e përqindjes së fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor në masën 59% në 2010.
- Shtimi i numrit të shkollave dhe klasave si dhe përmirësimi i mjediseve shkollore me synim arritjen e kushteve optimale mësimore dhe pajisja e shkollave me mjete laboratorike didaktike dhe kompjutera si dhe me pajisje të nevojshme shkollore.
- Rritja e rezultateve të shkollimit nëpërmjet zbatimit të standardeve të përmbajtjes dhe të arritjes.
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet rritjes së motivimit të mësuesve dhe trajnimit e kualifikimit të tyre.
- Sigurimi i kushteve për arsimimin e shtresave të marginalizuara.
- Zhvillimi sasior dhe cilësor i arsimit parashkollor.
- Matja e performancës së sistemit arsimor nëpërmjet vlerësimeve.
- Përfshirja në masën 82% (nga 80% që është aktualisht dhe 90% që synohet në vitin 2015) e nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Konsolidimi i Maturës Shtetërore nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithpërfshirës.
- Shtrirja e vlerësimit të standardizuar dhe të përqëndruar në të gjithë sistemin arsimor.
- Arsimi profesional dhe social-kulturor tu përgjigjet nevojave të tregut të punës në shërbime si hoteleri-turizëm, mirëmbajtje riparim automjesh, hidro-sanitare etj.
- Hartimi i listës së profesioneve dhe standardeve të tyre, krijimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve Profesionale.

- Futja e sistemit të kualifikimit të parapunësimit për specialistët e arsimit profesional dhe social-kulturor.
- Rritja e numrit të studentëve në tre ciklet e studimit në masën 15%, në raport me vitin paraardhës.
- Plotësimi i nevojave akademike e kërkimore të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përmirësimi i skemës dhe efektivitetit të mobilitetit të studenteve dhe personelit akademik.
- Integrimi sa më i shpejt i të diplomuarve në tregun vendas dhe global të punës, nëpërmjet reformës në kurrikul, ECTS, si edhe të dhënave shoqëruese të Supplementit të Diplomës.
- Rritja e cilësisë së studimeve Master dhe Doktoraturë, si edhe krijimi i kushteve për implementimin e studimeve Master në ato Shkolla të Larta ku garantojen standardet akademike.
- Njohja e të gjitha formave të studimit nëpërmjet procedurave standarde dhe institucionalizimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.
- Integrimi i Universiteteve dhe Institucioneve kërkimore shkencore në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, si dhe në rrjetin e programeve europiane të kërkimit shkencor.
- Implementimi i institucioneve dhe i biznesit privat në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit.
- Reformimi i sistemit të kërkimit shkencor, menaxhimi i programeve të kërkimit shkencor dhe integrimi i kërkimit shkencor me atë evropian, integrimi i institucioneve dhe biznesit privat në veprimtari kërkimore shkencore.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e skemës së menaxhimit të sistemit arsimor, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance dhe rritjes së kapaciteteve në të gjitha nivelet e shërbimit. Prioritetet dhe objektivat sektoriale, marrin parasysh ndërthurjet me strategjitë e sektorëve të tjerë dhe ato ndërsektorale, veçanërisht ato që lidhen me decentralizimin e shërbimeve, zhvillimin e pritshëm ekonomik, uljen e varfërisë, zhvillimet demografike dhe eliminimin gradual të shpërpjesëtimeve rajonale, sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë fëmijët dhe mbështetjen e shtresave në nevojë.

3.2 ARSIMI BAZË (PËRFSHIRË PARASHKOLLORIN)

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e kushteve të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe sigurimi i kushteve të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës; përmirësimi i kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe sigurimi i kushteve të barabarta për pjesëmarrje në arsimin parashkollor; konsolidimi i sistemit 9-vjeçar në strukturë, përmbajtje dhe kurrikulë.

3.3 ARSIMI I MESËM (I PËRGJITHSHËM)

Politika e këtij programi synon reformimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm në bazë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, rritjen graduale të tërheqjes në arsimin e mesëm të përgjithshëm të nxënësve që përfundojnë arsimin e detyruar.

3.4 ARSIMI I MESËM (PROFESIONAL)

Politika e këtij programi konsiston në rritjen graduale të numrit të nxënësve që studiojnë në këtë lloj arsimimi, përmes krijimit të mundësive të reja; zgjerimi i autonomisë së shkollave dhe bashkëpunimit me komunitetin; ngritja dhe fuqizimi i reparteve dhe kabineteve të reja; ndryshimi i strukturës së arsimit profesional dhe social-kulturor; krijimi i mekanizmave institucionale për kualifikimin e personelit mësimdhënës dhe drejtues.

3.5 ARSIMI UNIVERSITAR

Reforma e Arsimit të Lartë është e mbështetur në parimet dhe objektivat e "Procesit të Bolonjës". Kjo reformë ndërtohet mbi bazën e masterplanit të Arsimit të Lartë dhe është e pasqyruar në projektligjin për Arsimin e Lartë. Reforma synon: të formojë e përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj në të gjitha fushat, të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe integritit të tij në BE; të sigurojë kualifikimin e vazhdueshëm profesional, nëpërmjet zhvillimit të programeve të ndryshme të studimit, trajnimit e specializimit, bazuar në konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor duke ofruar studime të thelluara apo aplikative, në mbështetje të zhvillimit ekonomik e social të vendit; të ruajë, të rrisë dhe të zhvillojë bazën e dijeve të shoqërisë, si dhe të kulturës kombëtare e ndërkombëtare.

3.6 FONDE PËR SHKENCËN

Politika e programit të kërkimit shkencor synon: të përcaktojë objektivat, drejtimet dhe përparësitë e veprimtarisë shkencore e të zhvillimit teknologjik duke i harmonizuar me zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit; të përcaktojë drejtimet dhe objektivat e përmirësimit të vazhdueshëm të strukturës së rrjetit të institucioneve shkencore dhe të fuqizimit të universiteteve si qendra të veprimtarisë shkencore dhe të zhvillimit teknologjik; të forcojë lidhjet funksionale dhe operacionale të veprimtarisë shkencore dhe të zhvillimit teknologjik me kërkesat e ekonomisë së tregut; të stimulojë integrimin e veprimtarisë kombëtare të kërkimit e të zhvillimit në veprimtarinë shkencore dhe teknologjike në nivel rajonal, europian, botëror; të reformojë sistemin e kërkimit shkencor, menaxhimin e programeve të kërkimit shkencor; integrimin e kërkimit shkencor me atë evropian; integrimin e institucioneve dhe biznesit privat në veprimtari kërkimore shkencore.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Përmirësimi i kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASH), rajonal (DAR dhe ZA), lokal (shkollat) si dhe i institucioneve që varen nga MASH.
- Instalimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor (EMIS).
- Reformimi i sistemit të financimit dhe rritja e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.
- Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së shërbimit arsimor.
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore brenda sektorit duke siguruar: bërjen e rekrutimeve sipas ligjit; përditësimin e termave të referencës e përshkrimeve të punës të qarta për të gjithë stafin; specifikimin e qartë dhe zbatimin në mënyrë korrekte të statusit të mësuesit; forcimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për përfshirje të gjërë në trajnime
- Planifikimi dhe futja e sistemeve të menaxhimit me bazë performance në të gjitha institutet, qendrat dhe agjencitë që varen nga MASH.
- Vazhdimi i zhvillimit të politikave të qarta për funksionet e MASH në kuadër të decentralizimit si dhe hartimi i udhëzimeve dhe akteve nënligjore përkatëse për DAR, ZA dhe shkollat për funksionet e decentralizuara.
- Instalimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor (EMIS).
- Zhvillimi i politikave të qarta për reformimin e sistemit të financimit dhe rritjen e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.
- Miratimi dhe/ose amendimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për të nxitur shkollat që të vjelin të ardhura nga shërbimet.
- Zhvillimi dhe diskutimi i modelit të financimit "për nxënës".

Produktet që do të ofrohen

- 50 auditime të institucioneve të sistemit arsimor.
- 100 drejtorë shkollash të trajnuar.
- 10 DAR dhe 20 ZA të vlerësuara nga inspektimi.
- 100 punonjës të trajnuar në fushën e financës dhe prokurimeve.
- 8 ambiente pune të rehabilituara.
- 12 pajisje elektronike të blera.

4.2 ARSIMI BAZË (PËRFSHIRË PARASHKOLLORIN)

Objektivat e politikës

- Ndërtime të reja shkollore dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese, kryesisht në zonat urbane, dhe sigurimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve.

- Hartimi i kurrikulës së re (tekste) për klasën e V, dhe XI të arsimit të bazë si dhe përmirësimi i kurrikulave të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze.
- Shtimi dhe përmirësimi i pajisjeve shkollore të reja dhe pajisjeve laboratorike për shkencat natyrore si dhe mjeteve didaktike dhe kompjuterave në masën 50%.
- Pajisja në 100% e numrit të nxënësve me tekste shkollorë.
- Trajnimi i mësuesve në shërbim për kurrikulën e re të klasave IV dhe VIII si dhe për lëndë të veçanta për përgatitjen e tyre në mësues shumë lëndësh për nivelin fillor, në masën 20%. Trajnimi i mësuesve të shkollave gjithëpërfshirëse, në masën 3%. (12 kopshte dhe 12 shkolla çdo vit).
- Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor duke arritur tërheqjen e 54% të grup moshës 3-6 vjeç.
- Organizimi i vlerësimit kombëtar për klasën V të arsimit bazë si: krijimi i kushteve për mësimdhënie dhe mësimnxënie; ulja e numrit të nxënësve për klasë në qytetin e Tiranës; përmirësimi i kushteve në shkolla.

Produktet që do të ofrohen

- 32 kurrikula të reja të hartuara.
- 114 libra shkollore të publikuar.
- 410000 nxënës që ndjekin Arsimin Bazë.
- Rreth 6000 mësues të trajnuar në bazë të kurrikulave të reja për klasat V dhe IX
- Ndërtim i 274 klasave të reja.
- Rikonstruksion i 420 klasave në shkallë vendi.
- Rritja në 54% e numrit të fëmijëve 3 deri 6 vjeç në arsimin parashkollor
- 750 kopshte dhe shkolla me kushte të përmirësuara.
- Dixhitalizimi i amzave.
- 200 pajisje kompjuterike dhe mobileri për kabinetet informatike.
- 40 shkolla që furnizohen me pajisje mobilierie për laboratorë.
- Krijimi i 30 bibliotekave shkollore.

4.3 ARSIMI I MESËM (I PËRGJITHSHËM)

Objektivat e politikës

- Tërheqja në arsimin e mesëm të përgjithshëm të 82% të nxënësve që mbarojnë arsimin bazë.
- Hartimi i planit të ri mësimor dhe programeve të reja lëndore sipas strukturës së re të arsimit të mesëm të reformuar.
- Ndërtime dhe rehabilitime shkollash, me prioritet zonat urbane, duke ulur numrin e nxënësve që mësojnë në kushte jonormale me 25% të numrit të përgjithshëm, nëpërmjet ndërtimit të 11 shkollave të mesme të përgjithshme dhe rehabilitimit të 25% të shkollave.
- Pajisja me laborator dhe mjete didaktike e 70% të shkollave.
- Pajisja me laborator të informatikës e 100% të shkollave dhe lidhja me internet.
- Pasurimi i bibliotekave shkollore në bazë të numrit të nxënësve për shkollë.

Produktet që do të ofrohen

- Korniza kurrikulare e AML e përfunduar
- Plani mësimor i AML i përfunduar
- 25 programe të hartuara
- 30 laboratoreve të shkencave për shkollat e mesme
- 78 Tekste të reja shkollore.
- 65 Programe edukimi të realizuara.
- Ulja e numrit të nxënësve në klasë, deri në 35 nxënës për klasë, në masën 50% të shkollave.
- 100% të shkollave të mesme me kabinete informatike.

4.4 ARSIMI I MESËM (PROFESIONAL)

Objektivat e politikës

- Përfshirja në arsimin profesional dhe social-kulturor e 26% të nxënësve që vijojnë arsimin e mesëm.
- Përgatitje për hartimin e kurrikulës së re, në kuadrin e zbatimit të arsimit të detyruar 9 vjeçar, sipas strukturës së re të arsimit profesional.
- Zbatimi i mëtejshëm i degëve të reja konfeksion-stilim dhe peshkim.
- Pajisja e 5 reparteve të praktikave profesionale me makineri e pajisje teknologjike si dhe e 3 shkollave social-kulturore dhe 6 shkolla profesionale me laboratorë për lëndët profesionale bazë si: shërbim e mirëmbajtje automobilash, instalues-hidraulik, kuzhinë e reception, vegla muzikore etj.
- Plotësim i listës së profesioneve dhe ndërtimi i Kornizës Shqiptare të Kurrikulës së Arsimit dhe Formimit Profesional.
- Hartimi i dokumentacionit bazë për 15 kualifikime (profesione).
- Trajnimi i 20% të specialistëve.
- Ndërtim i dy shkollave të reja dhe dy bazave prodhuese.

Produktet që do të ofrohen

- Rritja e numrit të nxënësve në arsimin profesional dhe social kulturor në kuotën e rreth 26% të nxënësve që vazhdojnë arsimin e mesëm.
- Hartimi i programeve dhe kurrikulave.
- Trajnimi i mësuesve e drejtuesve të shkollave, si dhe vlerësimi nëpërmjet pagës i kontributit të tyre.
- 50 tekste të hartuara dhe të publikuara.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies në shkollat profesionale.
- 12 Laboratorë fizikë, kimi, biologji për shkollat e mesme profesionale.
- 35 Pajisje për kabinete.
- 12 Laboratorë në shkollat profesionale.
- Shkolla të reja profesionale dhe social kulturore.
- Ndërtimi i shkollës së re austriake Shkodër.

4.5 ARSIMI UNIVERSITAR

Objektivat e politikës

- Rritja e numrit të studentëve në tre ciklet e studimit në masën 15%, në raport me vitin paraardhës.
- Plotësimi i nevojave akademike dhe kërkimore të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), nëpërmjet pjesëmarrjes me projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- Përmirësimi i skemës dhe efektivitetit të mobilitetit të studentëve dhe të personelit akademik,
- Rritja e cilësisë së integritit të të diplomuarve në tregun e punës nëpërmjet të kuptuarit cilësor të pikëve të kreditit e të dhënave shoqërore të “Suplementit të Diplomës”.
- Rritja e cilësisë së studimeve “master” dhe “doktoraturë”, si edhe krijimi i kushteve për implementimin e studimeve “master” në ato IAL, që nuk i ofrojnë ato dhe ku garantohen standardet akademike.
- Njohja e të gjitha formimeve nëpërmjet procedurave standarde dhe institucionalizimi i kornizës kombëtare të kualifikimeve.
- Shtimi i numrit të studentëve me kohë të plotë, të pjesëshme dhe edukimi në distancë, në masën 15% ndaj vitit paraardhës.
- Zgjerimi i studimeve “master” në 3 universitete të rretheve : USH, UE dhe në UGJ
- Përmirësimi i standardeve të planeve dhe i programeve mësimore në masën 70-75 %.
- Akreditimi i diplomave dhe i kurseve të studimit në masën 30%.
- Përmirësimi i procedurave dhe rritja e numrit të njohjes së diplomave të huaja të njohura në Shqipëri (MASH e IAL).
- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për AL.
- Heqja e tarifave të shkollimit për kategori të veçanta sociale.

Produktet që do të ofrohen

- Përmirësimi i sistemit të akomodimit si dhe mbështetja sociale me bursa e studenteve.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet përmirësimit të kurrikulave, Akreditimi i Universiteteve sipas “Deklaratës së Bolonjës” për të arritur standardet evropiane.
- Rritja e numrit të studentëve.
- Krijimi i rrjetit telematik në arsimin universitar.
- 11 Biblioteka të rehabilituara.
- 5 Makineri teknologjike për universitete.

4.6 FONDE PËR SHKENCËN

Objektivat e politikës

- Hartimi i një kuadri ligjor dhe institucional për një menaxhimin cilësor të kërkimit shkencor dhe krijimi i platformës kombëtare të kërkimit shkencor.

- Orientimi i tregut të kërkimit shkencor nëpërmjet forcimit të lidhjeve të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor me biznesin privat.
- Dokumenti i Orientimit të Kërkimit Shkencor për reformimin e sistemit të kërkimit shkencor.
- Ristrukturimi i institucioneve të kërkimit shkencor dhe legjislacioni i ri për sistemin e kërkimit shkencor si dhe aktet normative.
- Futja e indikatorëve të OECD për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore.
- Rritje me 25% e buxhetit për programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit.
- Rritje me 25% të buxhetit për programet ndërkombëtare (dypalëshe dhe shumëpalëshe) në bashkëpunim me struktura dhe iniciativa evropiane të kërkimit shkencor.
- Zgjerimi i marrëveshjeve dypalëshe me Austrinë dhe Malin e Zi.
- Zgjerimi i aktiviteteve për përfshirjen e biznesit privat në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe financimi i projekteve.

Produktet që do të ofrohen

- 70 Programe kombëtare të kërkimit shkencor dhe Integrimi i kërkimit shkencor shqiptar me atë evropian.
- 4 Projekte të rëndësisë së veçantë.
- 100 Programe bilaterale të kërkimit Shkencor.
- 2200 Programe të kërkimit shkencor në Universitete.

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subvecionet 603	Të tjera transferte korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	548	281	0	0	0	102	931
Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin)	16,055	950	260	0	0	3,946	21,211
Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	3,391	272	40	0	0	1,392	5,095
Arsimi i Mesëm (profesional)	1,743	302	10	0	0	575	2,630
Arsimi Universitar	4,308	695	380	5	300	1,322	7,010
Fonde për Shkencën	0	95	0	0	100	197	392
Total	26,045	2,596	690	5	400	7,534	37,270

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Arsimi Bazë		
Rritja e raportit të regjistrimit neto (NER) të nxënësve që frekuentojnë arsimin bazë deri në 2008.	0.2%	
Shtimi i numrit të shkollave/klasave (ndërtim /rikonstruksion)	%	
Arsimi i mesëm		
Shkolla të pajisura me laboratorë të rinj/pajisje didaktike	Nr	
Cilësia e përvetësimit të njohurive	N.mes	
Hartimi i kurrikulave për klasat 10 dhe 11-12		
Përfshirja e nxënësve në arsimimin e mesëm	%	
Përfshirja e ICT-së në shkollat ku mësojnë nxënës të arsimit parauniversitar	%	
Arsimi i Lartë		
Përfshirja e studentëve me kohë të plotë dhe të pjesshme në AL	Nx/kom	
Përfitimi i fondeve të ekselencës	%	
Kërkimi shkencor		
Programet dhe projektet e PKKZH-së të financuara	Nr	
Përfitimi i projekteve ndërkombëtare me aplikim	Nr	
Financimi i shërbimit arsimor	nr	
Financimi i shërbimit arsimor	% e GDP-se	

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektvendim për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit të tyre.
- Projektvendim për transportin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të nxënësve ku nuk mundësohet transporti me linjat e miratuara nga Këshilli i Qarkut.
- Amendimi i Ligjit 8872 datë 29.03.2002 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional" në Republikën e Shqipërisë.
- Amendimi i VKM 120, datë 27.1.1997 "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor".
- Amendimi i ligjit nr. 7951, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar.
- Projektvendim "Për ndryshimin e VKM "Për maturën shtetërore".
- Projektvendim "Për krijimin e agjencisë së pranimeve në arsimin e lartë".
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë në programin e shtatë në Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, dhe zhvillimin teknologjik.
- Projektvendim "Për përcaktimin e standardeve kritereve dhe procedurave për hapjen, ndryshimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë".
- Projektvendim "Për miratimin e rregullores së Këshillit të arsimit të lartë dhe shkencës".
- Projektvendim "Për Kartën e Studentit".
- Projektvendim "Për përcaktimin e nivelit të pagave për kategoritë e personelit akademik në IAL si dhe ato me kontratë".
- Projektvendim "Për ndarjen në nivele brenda secilës kategori të personelit akademik, si dhe për përcaktimin me hollësi të kritereve për fitimin e shkallëve të kualifikimit për secilin rast".
- Projektvendim "Për shpërblimin e punonjësve të AVA që realizojnë procesin e Maturës Shtetërore 2008".
- Projektvendim "Për Statusin e Profesorit, aspekte të trajtimit të veçantë të tij si dhe përfitime të tjera për personelin akademik".
- Projektligji "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve të arsimit parauniversitar".
- Miratimi i akteve të reja nënligjore për zbatimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 7893, dt. 22.12.1994, "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik" i ndryshuar me ligjin nr. 8401, dt. 09.09.1998.
- Projektvendim për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në shkollat e larta në sistemin me kohë të plotë për vitin akademik 2008-2009.
- Projektvendim "Për kuotat financiare të ushqimit të nxënësve në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studenteve, në institucionet arsimore publike për vitin akademik 2008-2009".
- Projektvendim për hapjen e programeve të reja të studimit në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për ciklin e parë dhe të dytë.

- Projektvendim për hapjen apo mbylljen e strukturave të reja akademike të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.
- Projektvendim për kuotat e pranimit në vitin akademik 2008-2009 në studimet me kohë të plotë.
- Projektvendim për miratimin e Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë ose të agjensive të huaja të akreditimit, pjesë e ENQA-s.
- "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për bashkëpunimin në fushën e arsimit".
- "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik".
- Projektvendim "Për nivelet e arsimit dhe Formimit Profesional".
- Projektvendim për mbajtjen e statistikave dhe indikatorëve në fushën e kërkimit shkencor.
- Projektvendim "Për krijimin e institucioneve zbatuese të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve".
- Projektvendim "Për shtrirjen e shërbimeve të fëmijërisë së hershme në zonat e margjinalizuara me alternativa të reja të bazuar në pilotime".
- Projektvendim "Për sistemin e orientimit dhe këshillimit profesional" .
- Projektvendim "Për legalizimin e pronave të universiteteve dhe shkollave të larta".
- Projektvendim "Për transferimin e studimeve".
- Projektvendim "Për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve profesionale".
- Projektvendim Strategjia e Kërkimit Shkencor.

Projektvendim "Për kuotat e pranimit në vitin akademik 2008 - 2009 në studimet me kohë të pjesshme".

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

- Projekt VKM “Për shtrirjen e shërbimeve të fëmijërisë së hershme në zonat e marginalizuara me alternativa të bazuar në pilotime”.
- Udhëzim “Për vendosjen në skemën e arsimit të detyruar të grupmoshës 5-6 vjeçare bazuar në pilotim”.
- Rishikimi i Dispozitave Normative të Arsimit Parauniversitar dhe hartimi i akteve nënligjore përkatëse.
- Miratimi i akteve të reja nënligjore për zbatimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 7893, dt. 22.12.1994, “Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik”, i ndryshuar me ligjin nr. 8401, dt. 09.09.1998.
- Projekt-VKM “Për strukturën e arsimit të mesëm”.
- Amendim i Ligjit 8872, datë 29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM “Për sistemin e orientimit dhe këshillimit profesional”.
- Paketë ligjore për përputhje të plote me kuadrin ligjor evropian për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve profesionale.
- VKM “Për legalizimin e pronave të universiteteve dhe shkollave të larta”.
- Urdhër për rregullimin e punës me PEI-në (plani edukativ i individualizuar) dhe saktësimin e procedurave të pranimit dhe të vlerësimit fillestar e në proces të nxënësve me nevoja të veçanta.
- VKM “Për transferimin e studimeve”.
- Udhëzim për zbatimin e kurrikules së re në fillim të vitit shkollor.
- VKM “Për titujt akademik”.
- VKM “Për financimin e trajnimit të kujdestarëve të PAK të rëndë”.
- VKM për procedura të njohjes së diplomave sipas standardeve të BE-së në zbatim të paketës së re ligjore.

Aneks 3 Investimet publike

Buxheti	Kosto në lekë
Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	7,533,750,000
Aparati MASH e pajisje	883,170,000
Bashkia Tiranë	200,000,000
DAR/ZA	502,750,000
Institucionet Arsimore	6,600,000
Universitetet (total)	781,200,000
Bashki +Komuna Granti konkurues	1,846,730,000
Projekti E3	2,575,000,000
Të ardhurat	-
Financimi I huaj	738,300,000
Planifikim menaxhim	101,850,000
Aparati MASH	20,500,000
Bashkia Tiranë	
DAR/ZA	68,350,000
Institucionet Arsimore	-
Universitetet	-
Bashki +Komuna Granti konkurues	-
Projekti E3 (Sistemi EMIS)	13,000,000
Të ardhurat	-
Financimi I huaj	-
Arsimi bazë	3,946,400,000
Aparati MASH+Pajisje granti konkurues	247,870,000
Bashkia Tiranë	140,000,000
DAR/ZA	31,400,000
Institucionet Arsimore	6,600,000
Universitetet	-
Bashki +Komuna Granti konkurues	1,377,930,000
Projekti E3	1,994,000,000
Të ardhurat	-
Financimi I Huaj	148,600,000
Arsimi i mesëm	1,392,000,000
Aparati MASH+Pajisje granti konkurues	10,000,000
Bashkia Tiranë	60,000,000
DAR/ZA	10,000,000
Institucionet Arsimore	-
Universitetet	-
Bashki +Komuna Granti konkurues	468,800,000
Projekti E3	568,000,000
Të ardhurat	-
Financimi I Huaj	275,200,000
Arsimi mesem profesional	575,000,000
Aparati MASH	-
Bashkia Tiranë	
DAR/ZA	393,000,000
Institucionet Arsimore	-
Universitetet	-
Bashki +Komuna Granti konkurues	-

Projekti E3	-
Të ardhurat	-
Financimi i Huaj	182,000,000
Arsimi i Lartë	1,321,500,000
Aparati MASH (Buxheti i universiteteve+TVSH Tempus)	407,800,000
DAR/ZA	-
Institucionet Arsimore	-
Universitetet (TVSH)	10,000,000
Bashki +Komuna Granti konkurues	-
Projekti E3	-
Të ardhurat	771,200,000
Financimi i Huaj	132,500,000
Kerkimi Shkencor	197,000,000
Aparati MASH	197,000,000
Të ardhurat	
Financimi i Huaj	

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i Projektit	Vlera (Grant)	Donatori
Arsimi bazë		
Rehabilitimi shkollave të Tiranës	1.526.192	Këshilli i Evropës (Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës)
Cilësi e Barazi në arsim		BEI+CEB+BB
Projekte të vogla nga donatorë të ndryshëm	47000	Të ndryshëm
Arsimi i mesëm i përgjithshëm		
Projekti për furnizim me laboratorë të 70 shkollave të mesme	125000	Qeveria Italiane
Projekti për furnizim me kabinate informatike të 60 shkollave të mesme	125000	Qeveria Kineze
Arsimi i mesëm profesional		
Projekti në ndihmë të 5 shkollave profesionale në Shqipëri (furnizim me pajisje)	173300	Komisioni Evropian CARDS
Projekti Albvet në ndihmë të 5 shkollave profesionale në Shqipëri (furnizim me pajisje)	42900	Qeveria Zvicerane
Projekti Tour Reg në ndihmë të 2 shkollave hoteleri turizmit (furnizim me pajisje)	144000	Qeveria Austriake
Projekti Agri Al në ndihmë të 2 shkollave të mesme bujqësore	121500	Qeveria Austriake
Ndërtimi i shkollës së mesme austriake Shkodër		Qeveria Austriake
Arsimi universitar		
Projekti Tempus	372000	Komisioni Evropian CARDS
Projekti për krijimin e qendrës informacionit kërkimit dhe zhvillimit	250000	Qeveria Italiane

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Korrupsioni në arsim ka pasoja shkatërruese për të gjithë shoqërinë dhe vendin dhe lufta kundër tij brenda sistemit arsimor merr një rëndësi të veçantë. Objektivi kryesor i arsimit është transmetimi i dijeve së bashku me vlerat e integritetit moral, të barazisë, ndershmërisë dhe drejtësisë sociale.

Shkolla është institucioni që përgatit të ardhmen e një kombi dhe arsimimi "me duar të pastra" ndërton një të ardhme të shëndetshme për vendin.

Lufta kundër korrupsionit është në qendër të çdo reforme që ndërmerret në sistemin arsimor për faktin se është korrupsioni ai që pengon dhe komprometon rëndë çdo përpjekje që bëhet në drejtimin e duhur. Për këtë arsye ato duhen përqëndruar njëkohësisht qeverisje, transparencë dhe përgjegjshmëri.

1. Transparenca dhe gjithëpërfshirja në qeverisjen e arsimit

Në këtë aspekt janë shënuar arritje të konsiderueshme të cilat u mirëpritën dhe morën aprovimin e menjëhershëm të opinionit publik, si:

- Vendosja e Maturës Shtetërore nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës
- Shtrirja e vlerësimit të standardizuar dhe të përqëndruar në të gjithë sistemin arsimor;
- Vendosja e Librit të Transparencës për të gjitha shkollat e mesme;
- Futja e tekstit alternativ në shkollë, transparenca në përzgjedhjen dhe vlerësimin e teksteve alternative, nëpërmjet procedurave të hapura me pjesëmarrjen e ekspertëve të shquar të fushës së botimeve dhe të mësuesve e përdoruesve të teksteve shkollore.
- Rritja e transparencës, aksesit në vendimmarrje dhe sigurimi i rolit monitorues të nxënësve, mësuesve dhe prindërve, shoqërisë civile, grupeve të interesit, i komuniteteve vendore dhe të medias, duke përdorur mjetet e teknologjisë së informimit e komunikimit dhe ndërtimi i shërbimit "on-line".

Zhvillimi i mëtejshëm, pasurimi me elementë të rinj dhe konsolidimi i këtyre reformave, është një proces në vazhdim që dëshmon se antikorrupsioni është një prioritet permanent i politikave arsimore.

2. Vendosja e kontrollit dhe transparencës në menaxhimin e burimeve financiare.

Me anë të Bordit të Shkollës si dhe funksionimit të rregullt të qeverive studentore, komuniteti ka mundësi, të vëzhgojë efektivitetin dhe eficientën e investimeve dhe përdorimin e fondeve. Për këtë janë bërë hapa pozitivë në drejtim të vendosjes së kontrollit shoqëror mbi përdorimin e burimeve financiare. Në funksion të transparencës në arsim dhe antikorrupsionit, synohet :

- Rritja në vazhdimësi e pagës së mësuesit në masën 20% në vit;
- Decentralizimi në përgjithësi dhe rritja e autonomisë së shkollës në veçanti;
- Zbatimi i formulës "financim për nxënës" në shpërndarjen efiçente të fondeve në arsim.

Në këtë kontekst është planifikuar dhe vendosja së shpejti e "Urdhërit të Mësuesit " që do shërbejë për të stimuluar mësuesit e dalluar dhe ndëshkuar ata që do të përfshihen në korrupsion ose në praktika të ndryshme abuzive.

3-Edukimi dhe marrja e njohurive antikorrupsion për brezin e ri

Objektivi i sistemit arsimor në këtë aspekt është ndërgjegjësimi i brezit të ri për rrezikshmërinë e efekteve negative të fenomenit të korrupsionit.

Në këtë kuadër parashikohet :

- Përfshirja në programin mësimor të orëve edukative të detyruara, që trajtojnë tema lidhur me korrupsionin dhe luftën kundër tij .
- Seminare të hapura me nxënës e studentë për rrezikshmërinë e fenomenit të korrupsionit.